

Tridhjetë çështje bashkëkohore fikhore rreth agjërimit

Përgatiti

**Departamenti Shkencor pranë Fondacionit "Ed Durar
es Senije", nën mbikëqyrjen e Alevi Abdulkadir es
Sekafit**

Përktheu

Agron Krasniqi

Tridhjetë çështje bashkëkohore fikhere rreth agjërimit

Përgatiti

**Departamenti Shkencor pranë Fondacionit "Ed
Durar es Senije", nën mbikëqyrjen e Alevi
Abdulkadir es Sekafit**

Përktheu

Agron Milazim Krasniqi

Titulli

Tridhjetë çështje bashkëkohore fikhere rreth agjërimit

Përgatiti

Departamenti Shkencor pranë Fondacionit "Ed Durar es Senije", nën mbikëqyrjen e Alevi Abdulkadir es Sekafit

Përktheu

Agron Krasniqi

Redaktor gjuhësor

Jeton Koqinaj

Tridhjetë çështje bashkëkohore fikhere rreth agjërimit

1. Nëse agjëruesi bën iftar e pastaj ngrihet me aeroplan në qiell dhe sheh Diellin

Kush bën iftar në një vend e pastaj ngrihet me aeroplan, ose bën iftar duke qenë në aeroplan para nisjes, pasi të ketë mbaruar dita, pastaj e sheh Diellin pas ngritjes së aeroplanit në qiell, ky në këtë rast e vazhdon iftarin.

Kështu janë përgjigjur Abdurrezak Afifi, Ibn Bazi dhe Ibn Uthejmini.

2. Agjëruesi që gjendet në aeroplan, a duhet bazuar në të parët e Diellit apo në kohën e hyrjes së iftarit në vendin më të afërt që ka ose në drejtim të të cilit gjendet?

Kush udhëton me aeroplan duke qenë agjërueshëm, pastaj i bëhet e ditur përmes orës ose ndonjë mekanizmi tjetër se ka hyrë koha e iftarit në vendin prej të cilit ka udhëtuar, ose në vendin e afërt në drejtim të të cilit ndodhet gjatë fluturimit, mirëpo e sheh Diellin për shkak të lartësisë së aeroplanit, këtij nuk i lejohet të bëjë iftar vetëm se pas perëndimit të Diellit.

Kështu janë përgjigjur Abdurrezak Afifi, Ibn Bazi dhe Ibn Uthejmini.

3. Koha e iftarit në ato vende në të cilat dita është e tejzgjatur (vendet skandinave)

Agjëruesi e ka të obliguar të agjërojë që nga lindja e agimit të mëngjesit deri në perëndim të Diellit, në cilindo vend të Tokës që ndodhet, njësoj a është dita e shkurtër apo e gjatë ose janë të barabarta (dita dhe nata), përderisa ndodhet në një vend në të cilin ekziston ndërrimi i ditës dhe natës gjatë njëzet e katër orëve.

Mirëpo, nëse agjërimi i ditëve shumë të gjata i shkakton vështirësi të papërballueshme, saqë ka frikë se dëmtohet ose i shkakton ndonjë sëmundje, në këtë rast lejohet ta prishë agjërimin, ashtu që e kompenson më pas në ditët e tjera në të cilat ka mundësi të agjërojë.

Kështu janë përgjigjur Ibn Bazi, Ibn Uthejmini e të tjerë dhe ky është vendimi i Akademisë Fikhore Islame.

4. Mënyra e përcaktimit të fillimit dhe mbarimit të agjërimit në vendet në të cilat nuk ndërrohen dita dhe nata brenda njëzet e katër orëve

Kush ndodhet në një vend në të cilin nuk ndërrohen dita dhe nata gjatë njëzet e katër orëve, si për shembull në atë vend ku kohëzgjatja e ditës mund të jetë sa dy ditë, një javë, një muaj ose edhe më shumë, në këtë rast i përcaktohet ditës një kohë e caktuar dhe natës një kohë e caktuar, duke u bazuar në vendin më të afërt që kanë (në të cilin ndërrohen dita dhe nata), ashtu që shuma e përcaktuar për ditën dhe natën të jetë gjithsej njëzet e katër orë.

Kështu janë përgjigjur Ibn Bazi, Ibn Uthejmini e të tjerë dhe ky është vendimi i Akademisë Fikhore Islame.

5. Gjykimi ndaj atij që i ikën mendja dhe humb vetëdijen përmes mpirjes (anestezionit)

Atij që i ikën mendja dhe humb vetëdijen përmes anestezionit, merr gjykimin e atij që është alivanosur, gjegjësisht i ka rënë të fikët.

E, kush e bën nijet agjërimit, por pastaj alivanoset, për të ekzistojnë dy raste:

I pari:

Alivanosja t'i zgjasë tërë ditën, pra, është alivanosur para agimit të mëngjesit dhe nuk i është kthyer vetëdija deri pas perëndimit të diellit. Këtij nuk i vlen agjërimi dhe obligohet ta kompensojë këtë ditë. Ky është mendimi i shumicës së juristëve, atyre shafi, maliki dhe hanbeli, madje është përcjellë ujdia e tyre (konsensusi) në këtë.

I dyti:

T'i jetë kthyer vetëdija në një pjesë të ditës, qoftë dhe për një moment, atëherë agjërimi i tij është i saktë dhe nuk obligohet ta kompensojë. Ky është mendimi i juristëve shafi dhe hanbeli.

Mirëpo, ka raste kur anestezi i është shoqëruar me ndonjë lëndë ushqyese, e, nëse ndodh kjo, atëherë agjërimi priset, edhe nëse nuk zgjat mpirja gjatë tërë ditës.

6. Gjykimi për përdorimin e tabletave nga gruaja për të parandaluar ciklin menstrual, me qëllim që të agjërojë komplet muajin Ramazan, pa ndërprerje

Gruas i lejohet të përdorë ndonjë ilaç hallall për të vonuar ciklin menstrual, nëse sigurohet nga dëmi i tij, qoftë të jetë ky përdorim në Ramazan, me qëllim që

të agjërojë tërë muajin me njerëzit, qoftë në ndonjë kohë tjetër.

Këtë e kanë theksuar juristët hanbeli dhe e ka përzgjedhur atë Ibn Bazi.

7. Nëse banorët e një vendi kanë parë Hënën, dijetarët kanë rënë në mospajtim se a obligohen njerëzit e tjerë me agjërim bazuar në të parët e atij vendi apo secili vend ka shikim të veçantë?

Ka disa mendime, si:

I pari: Është obligim agjërimi për të gjithë njerëzit në përgjithësi.

Ky është mendimi i shumicës së dijetarëve, atyre hanefi, maliki dhe hanbeli, këtë e përzgjedhi Ibn Tejmije, Ibn Bazi e Albani dhe se në pajtim me të është marrë vendimi i Akademisë Fikhere.

I dyti: Nuk është obligim agjërimi për të gjithë njerëzit përderisa ka ndryshim në vendin e daljes ose shfaqjes së Hënës, mirëpo është obligim vetëm për vendin, banorët e të cilit e kanë parë Hënën, ose për vendin i cili ka të njëjtin gjykim, gjegjësisht e kanë të njëjtë pozitën e shfaqjes së Hënës.

Ky është mendimi i saktë i medh'hebit shafi dhe njëkohësisht mendimi i një grupi selefësh (gjeneratat e para), të cilin e përzgjodhi es San'ani dhe Ibn Utnejmini.

8. Gjykimi për të parët e Hënës përmes satelitëve

Nuk lejohet të bazuarit në satelitë për të parë Hënën.

Ky është mendimi i Ibn Utnejminut.

9. Gjykimi për përdorimin e vëzhguesve astronomikë në të parët e Hënës

Lejohet të përdoren vëzhguesit astronomikë për të parë Hënën, bie fjala, teleskopi që ndihmon për t'i parë më afër e më qartë sendet e largëta, mirëpo një gjë e tillë nuk është obligim. Nëse dikush e sheh Hënën përmes këtyre instrumenteve, duke qenë njeri i besueshëm, atëherë veprohet sipas asaj që ka parë ai.

Këtë mendim e përzgjodhi Ibn Bazi, Ibn Utnejmini dhe në përputhje me të është marrë vendim nga Komisioni i Përhershëm dhe Akademia Fikhore.

10. Llogaria astronomike

Nuk lejohet të punohet me llogari astronomike e as të bazohet në të për të vërtetuar hyrjen e muajit Ramazan. Dijetarët kanë rënë në ujdi (ixhma) për këtë çështje.

Këtë ixhma kanë përcjellë imamët e shquar, si: Xhasasi, Ibn Rushdiu, Kurtubiu dhe Ibn Tejmije.

11. Gjykimi për prishjen e agjërimit nga ana e udhëtarit nëse udhëtimi i tij është me automjete të rehatshme

Udhëtarit i lejohet të mos agjërojë, edhe nëse udhëtimi i tij është me automjete të rehatshme, pavarësisht a has vështirësi në të apo jo. Në lidhje me këtë, imam Ibn Tejmije ka përcjellë ixhmain e dijetarëve.

12. Gjykimi për konsumimin e duhanit gjatë agjërimit

Pirja e duhanit gjatë agjërimit e prish atë. Ky gjykim është në pajtim me katër medh'hebet fikhore, atyre hanefi, maliki, shafi dhe hanbeli.

13. Gjykimi për nxjerrjen e gjakut të koagulluar, si dhe marrja e gjakut për analizë

Për nxjerrjen e gjakut të mpiksur ose të koagulluar (të njohur si "el Fasd" (الفَسْدُ), i cili ka të bëjë me nxjerrjen e gjakut të mpiksur nga trupi, e ngjashme me hixhamen), dijetarët janë ndarë në dy mendime se a e prish agjërimit apo jo:

Mendimi i parë: Ky proces nuk e prish agjërimit. Ky është mendimi i shumicës së juristëve, atyre hanefi, maliki dhe shafi.

Mendimi i dytë: E prish agjërimit. Ky është një nga dy mendimet e medh'hebit hanbeli, të cilin e përzgjedhi Ibn Tejmije e Ibn Uthejmini dhe në përputhje me të kanë dhënë fetva Komisioni i Përhershëm.

Marrja e gjakut për analizë

Lejohet marrja e gjakut të agjëruesit për analizë. Ky mendim është përzgjedhur nga Ibn Bazi dhe Ibn Uthejmini.

14. Gjykimi për infuzionin anal

Për atë që merr infuzion përmes vrimës anale duke qenë agjërueshëm, dijetarët janë ndarë në dy mendime se a e prish agjërimin apo jo:

I pari: E prish agjërimin. Ky mendim është në pajtim të katër medh'hebeve juridike, atyre: hanefi, maliki, shafi dhe hanbeli.

Mendimi i dytë: Nuk e prish agjërimin. Këtë mendim e mbrojnë dijetarët dhahiri, po ashtu është mendim i disa dijetarëve maliki, gjykatësi Husejn nga medh'hebi shafi, gjithashtu këtë e ka thënë Hasen ibn Salihu. Atë e përzgjedhën: Ibn Abdulberri, Ibn Tejmije, Ibn Bazi dhe Ibn Uthejmini.

15. Pikat për hundë

Përdorimi i pikave në hundë gjatë ditës së Ramazanit ose marrja e ndonjë ilaçi përmes hundës e prish agjërimin.

Ky mendim është në pajtim të katër medh'hebeve juridike, atyre hanefi, maliki, shafi dhe hanbeli.

16. Pastrimi i veshkave

Atij që i bëhet pastrimi i veshkave, me çfarëdo metode që të jetë, i prishet agjërimi.

Ky është mendimi i Ibn Bazit dhe Komisionit të Përhershëm.

17. Spreji i astmës

Përdorimi i sprejit të astmës gjatë ditës së Ramazanit nuk e prish agjërimit. Këtë mendim përzgjedhën Ibn Bazi, Ibn Uttejmini e të tjerë, si dhe të këtij mendimi ishin shumica e pjesëmarrësve të Asamblesë së Nëntë Fikhore Mjekësore, pranë Organizatës Islame për Shkenca Mjekësore në Kuvajt.

18. Disqet që vendosen nën gjuhë

Janë një lloj i disqeve që përdoren për të kuruar disa kriza të zemrës, të cilat vendosen nën gjuhë dhe thithen menjëherë pas vendosjes së tyre, ku përmes gjakut përcillen deri në zemër dhe parandalojnë krizat e papritura të saj. Asgjë prej këtyre disqeve nuk hyn në stomak.

Andaj, përdorimi i këtyre disqeve nuk e prish agjërimit, me kusht që të mos gëlltitet ndonjë sasi gjatë tretjes së tyre.

Këtë mendim përzgjodhi Ibn Bazi dhe në përputhje të tij është marrë vendim nga Akademia Fikhore Islame me konsensus të tyre.

19. Oksigjeni

Përdorimi i *gazit të oksigjenit* për frymëmarrje nuk e prish agjërimitin.

Këtë mendim përzgjodhi Akademia Fikhore Islame pranë Organizatës së Konferencës Islame, në seancën e tyre të dhjetë.

20. Injeksionet joushqyese

Përdorimi i injeksioneve joushqyese për ilaçe nuk e prish agjërimitin, pavarësisht se a merren në muskuj, në vena gjaku apo nën lëkurë.

Këtë mendim përzgjodhi Ibn Bazi, Ibn Uthejmini e të tjerë. Gjithashtu ky është vendimi i Akademisë Fikhore Islame, si dhe fetvaja e Komisionit të Përhershëm dhe Degës për Fetva në Kuvajt.

21. Injeksionet ushqyese

Përdorimi i injeksioneve ushqyese në vena të gjakut e prish agjërimitin.

Ky është mendimi i Ibn Bazit, Ibn Uthejminit dhe vendimi i Akademisë Fikhore Islame dhe fetvaja e Komisionit të Përhershëm.

22. Supozitorët

Përdorimi i supozitorëve gjatë ditës së Ramazanit nuk e prish agjërimitin.

Ky mendim është në përputhje me medh'hebin dhahiri dhe disa dijetarëve maliki. Atë e përzgjodhi Ibn Uthejmini dhe shumica e pjesëmarrësve të Asamblesë së Nëntë Fikhore Mjekësore, pranë Organizatës Islame për Shkenca Mjekësore në Kuvajt.

23. Futja e endoskopit (kateterit) për ekzaminim të kanalit (traktit) urinar, ose futja e ndonjë ilaçi a dezinfektuesi për të pastruar fshikëzën urinare, ose ndonjë lëndë që vendoset në endoskop për të qartësuar pamjen e rentgenit (fotografimit)

Nëse agjëruesit i futet ndonjë lëng ose yndyrë në kanalën urinar, nuk e prish agjërimitin.

Ky është mendimi i shumicës së juristëve, atyre hanefi, maliki dhe hanbeli.

Gjithashtu, nuk e prish agjërimit futja e endoskopit (kateterit) për ekzaminim të kanalit (traktit) urinar, ose futja e ndonjë ilaçi a dezinfektuesi për të pastruar fshikëzën urinare, ose ndonjë lëndë që vendoset në endoskop për të qartësuar pamjen e rentgenit (fotografimit me rreze).

Ky është vendimi i marrë nga Akademia Fikhore Islame.

24. Vënia e pikave në organ të femrës, përdorimi i supozitorëve në të, përdorimi i materieve me ngjyra në pajisjen e rentgenit për ekzaminim gjinekologjik

Vënia e pikave në organin femëror nuk e prish agjërimit, as supozitorët që merren përmes tij e as futja e një lloj materieje me ngjyrë që përdoret për të kthjelluar fotografimin rentgen në organin gjenital.

Ky është vendimi i marrë nga Akademia Fikhore Islame.

Mjekësia moderne ka vërtetuar se nuk ka dalje (ndërlidhje) mes sistemit gjenital dhe sistemit të tretjes.

25. Gjykimi për përdorimin e pastës së dhëmbëve

Lejohet që agjëruesi të përdorë pastën e dhëmbëve, mirëpo duhet të ketë kujdes të mos depërtojë në fyt.

Ky është mendimi i Ibn Bazit, Ibn Utnejminit dhe Akademisë Fikhore Islame.

26. Përdorimi i pikave të syrit

Agjëruesit i lejohet përdorimi i pikave të syrit.

Ky është mendimi i medh'hebit hanefi dhe shafi. Atë e përzgjodhi Ibn Bazi dhe Ibn Utnejmini.

27. Përdorimi i pikave të veshit

Agjëruesit i lejohet përdorimi i pikave të veshit.

Këtë e përzgjodhi Ibn Hazmi, Ibn Bazi dhe Ibn Utnejmini.

28.Pastruesi i veshit

Në përgjithësi ky pastrues përmban një sasi të ujit: nëse uji depërton në fyt dhe e gëlltit atë, atëherë e prish agjërimin, siç ndodh nëse timpani i veshit është i shpuar, atëherë në këtë rast uji arrin në fyt. Ndërkaq, nëse nuk arrin ndonjë gjë në fyt, atëherë nuk e prish agjërimin.

Ky është vendimi i marrë nga Akademia Fikhore Islame.

29.Vajrat dhe kremrat

Vajrat dhe kremrat e ndryshme që përdoren për të lyer trupin nuk e prishin agjërimin.

Këtë e përzgjodhi Ibn Tejmije, Ibn Utnejmini dhe ky është vendimi i Akademisë Fikhore Islame.

30. Të provuarit e ushqimit në rast nevoje

Agjëruesit i lejohet ta provojë ose ta kërkojë ushqimin në rast se ka nevojë ose dobi, për shembull: ta dijë se a është pjekur ose a ka kripë, ose kur blen ushqimin e provon atë për ta zgjedhur; me kusht që ta hedhë menjëherë, ose ta pastrojë gojën, ose ta fshijë gjuhën.

Ky është mendimi i shumicës së dijetarëve, atyre hanefi, shafi dhe hanbeli.

Ndërkaq, të provohet ushqimi pa nevojë është e urryer, me pajtimin e katër medh'hebeve juridike, atyre hanefi, maliki, shafi dhe hanbeli.

Falënderimi i takon Allahut!

